

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6507
E hënë, 24 janar 2022
çmimi 0.40

Kjo javë fillon me acar edhe më të ashpër FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RIKTHEHET NË FUNKSION BLLOKU B2 I TERMOCENTRALIT "KOSOVA B"



Është rikthyer të dielën në funksion blloku B2 i Termocentralit "Kosova B". KEK-u ka bërë me dije se pas përfundimit të punimeve sipas dinamikës së paraparë dhe pas testeve, njësia B-2 është duke prodhuar me kapacitet të plotë. Kryeministri Albin Kurti e ka mirëpritur rikthimin e këtij blloku, duke thënë se tani Kosova për çdo orë do t'i paguajë rreth 50 mijë euro import më pak. Ndërsa përfaqësuesit e opozitës i kanë kërkuar përsëri kryeministrit që të mos lejojë shtrenjtimin e rrymës

AKTUALE



NISIN BISEDIMET MIDIS TALIBANËVE DHE PJESËTARËVE TË SHOQËRISË CIVILE F. 2

78 PËR QIND E PUNONJËSVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS JANË VAKSINUAR ME DY DOZA KUNDËR COVID F. 6

DY SHKOLLA NË KAMENICË VAZHDOJNË MËSIMIN ONLINE F. 6

EKONOMI



ME ZANAT E PA PUNË F. 7

SPORT



PRISHTINA MPOSHTI BASHKIMIN NË PRIZREN, TREPÇA SHKATËRROI DRITËN F. 11

DASH: Kosova dhe Serbia ta kenë prioritet dialogun

FAQE 5



NJË I VDEKUR DHE RRETH 3 000 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nisin bisedimet midis talibanëve dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile

OSLO, 23 JANAR - Një delegacion i talibanëve po viziton për herë të parë Evropën që prej se ky grup militant mori pushtetin në Afganistan tekta përfaqësuesit talibanë po marrin pjesë në bisedimet me pjesëtarët e shoqërisë civile afgane.

Bisedimet po mbahen në Norvegji dhe ato do të fokusohen në të drejtat e njeriut.

Delegacioni i talibanëve po kryesohet nga ushtruesi i detyrës i ministrit të Jashtëm, Amir Khan Muttaqi. Talibanët do të zhvillojnë bisedime me aktivistët, gazetarët dhe pjesëtarë të tjerë të shoqërisë civile përpara se më 24 dhe 25 janar të takohen me diplomatët perëndimorë.

Ministria e Jashtme norvegjeze tha se delegacioni taliban do të takohet edhe me

afganët që gjenden në këtë shtet, përfshirë "lideret gra, gazetarët dhe personat që punojnë për të drejtat e njeriut, për çështjet humanitare, ekonomike, sociale dhe politike".

Një delegacion i Shteteve të Bashkuara, i kryesuar nga përfaqësuesi i posaçëm për Afganistan, Tom West, planifikon që në bisedimet me talibanët të diskutojë për "formimin e një sistemi përfaqësues politik, për përgjigjen urgjente humanitare dhe krizën ekonomike, për shqetësimet e sigurisë dhe kundërterrorizmit, për të drejtat e njeriut, veçanërisht për arsimimin e grave dhe vajzave", u tha në një deklaratë të lëshuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Më 21 janar ministrja e Jashtme norvegjeze, Anniken Huitfeldt, theksoi se vizita



nuk paraqet "legjitimim apo njohje të talibanët. Por, ne duhet të bisedojmë me ata që qeverisin sot shtetin". "Ne jemi thellësisht të shqetësuar lidhur me situatën serioze në

Afganistan", tha Huitfeldt, duke theksuar se kushtet ekonomike dhe politike kanë krijuar "një katastrofë humanitare të shkallës së gjerë për miliona persona" që përballen me uri në

Afganistan.

Talibanët kanë marrë kontrollin e Afganistanit në mesin e gushtit të vitit të kaluar. Qeveria e shpallur prej tyre nuk është njohur ndërkombëtarisht.

Gjermania përballlet me rritje të rasteve me Omicron

BERLIN, 23 JANAR - Gjermania po përballlet me rritje të rasteve me koronavirus pavarësisht se më shumë se gjysma e popullsisë është imunizuar me dozën përforcuese të vaksinës kundër koronavirusit.

Rastet janë rritur shumë në Gjermani, veçanërisht në Berlin, që ka shënuar numrin më të madh të rasteve në 100 000 banorë në shtatë ditë. Instituti "Robert Koch" tha se në Berlin shkalla e incidencës brenda shtatë ditëve ishte 1 473. Në Gjermani, 41.7 milionë banorë nga popullsia prej 82 milionë banorësh, sipas këtij instituti, janë imunizuar me dozën përforcuese.

Qeveria gjermane tha se situata në njësitë e kujdesit intensiv ishte nën kontroll dhe 16 për qind e shtretërve spitalorë aktualisht janë të zënë me pacientë të prekur me sëmundjen Covid-19. Megjithatë, spitalet gjermane shpejt do të përballen me numër të madh të pacientëve për shkak të valës së shkaktuar nga varianti Omicron i koronavirusit, tha virologu Oliver Keppler. "Unë mendoj se klasifikimi i shpeshtë i Omicronit si variant i 'butë' do të jetë jashtëzakonisht i rrezikshëm", tha Keppler për dpa.

Situata në Gjermani është e vështirë për shkak të moshës

mesatare të vendit, që është e lartë, por edhe numrit të njerëzve të pavaksinuar, tha Keppler.

Mijëra gjermanë kundërshtuan masat e vendosura për ta frenuar koronavirusin dhe vaksinimin e detyrueshëm dhe më 22 janar u protestua në mbarë vendin.

Mbi 7 500 persona protestuan në Dyseldorf, tha policia dhe rreth 2 300 persona dolën në rrugët e Regensburg, ku dolën edhe qytetarë të tjerë që tentuan ta prishnin protestën e qytetarëve që kundërshtonin masat. Tre protestues u ndaluan. Ndërkaq, mbi 1 000 qytetarë protestuan në mënyrë paqësore në

Shtutgard dhe protestuesit u ndalën para transmetuesit publik, duke kritikuar mbulimin mediatik të pandemisë.

Në Zelandën e Re, që është një prej shteteve të pakta që ka shmangur shpërthimet me Omicron, kryeministrja Jacinda Ardern pranoi se do të jetë e pamundur që të shmanget përhapja e këtij varianti për shkak të transmetueshmërisë së lartë. Ajo njoftoi se nga 23 janari në Zelandën e Re do të aplikohen masa të reja, pasi janë regjistruar nëntë raste me Omicron në një familje që kishte udhëtuar nga jashtë vendit për të marrë pjesë në një dasmë.

Në masat e reja do të përfshihet mbajtja e maskave gjatë përdorimit të transportit publik dhe në dyqane si dhe kufizimi i tubimeve, por Ardern tha se nuk do të ketë izolim, duke shtuar se bizneset mund të hapen dhe njerëzit mund t'i vizitojnë familjarët e miqtë dhe mund të lëvizin lirshëm në mbarë vendin.

Masat e reja në Zelandën e Re do të jenë në fuqi të paktën deri në fund të muajit të ardhshëm. Ardern, po ashtu, njoftoi se për shkak të Omicronit, ajo dhe partneri i saj Clark Gayford kanë anuluar planet për dasmën e tyre.

Papa thotë se është i shqetësuar për krizën në Ukrainë



VATIKAN, 23 JANAR - Papa Françesku ka bërë thirrje për një ditë ndërkombëtare "të lutjeve për paqe" më 26 janar, që të ndalet kriza në Ukrainë. Ai, po ashtu, bëri thirrje që bisedimet politike të kenë në fokus "vëllazërinë njerëzore në vend të interesave partiake". "Po ndjek me shqetësim rritjen e tensioneve që kërcënojnë të

shkaktojnë një goditje të re të paqes në Ukrainë dhe të vënë në pikëpyetje sigurinë në Evropë, që mund të ketë edhe pasoja më të gjera", tha Papa më 23 janar.

Vatikani nuk dha ndonjë detaj se si Papa do ta shënojë ditën ndërkombëtare për lutje për paqe për Ukrainën. Shtetet e Bashkuara dhe NATO kanë paralajmëruar se

grumbullimi i mbi 100 000 trupave ruse në kufi me Ukrainën mund të jetë përgatitje për një pushtim të mundshëm të Ukrainës.

Moska, që ka mohuar se po planifikon ta pushtojë Ukrainën, ka kërkuar garanci nga NATO që do ta ndalonte anëtarësimin e ish-shteteve sovjetike, siç është Ukraina, në këtë aleancë ushtarake.

Një i vdekur dhe rreth 3 000 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se më 23 janar është regjistruar një viktimë dhe 2 957 raste të reja me koronavirus.

Rastet e reja dalin pas testimit të 11 913 mostrave. Nga kjo shifër del se 24.82 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me sëmundjen Covid-19.

Numri i infektiveve ditore është më i ulët krahasuar me një ditë më parë, kur në Kosovë u shënuan 3 206 raste.

Në raportin e Ministrisë së Shëndetësisë, që u referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, bëhet me dije se janë shëruar edhe 458 persona. Ndërkaq, raste aktive me koronavirus aktualisht janë 17 743.

Ndërkaq 111 pacientë të konfirmuar me Covid-19 dhe 30 post-Covid-19 janë të shtrirë për trajtim mjekësor në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Me oksigjenoterapi janë 49 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë të shtrirë katër pacientë.

Sa i përket vaksinimit, punëtorët shëndetësorë kanë administruar edhe 6 806 doza të



vaksinës kundër koronavirusit. Deri më tani në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 801 281 persona, me dozën përforcuese 44 143 dhe me atë të tretë janë imunizuar 10 781 persona.

Në Kosovë të gjithë personat mbi 12 vjeç mund të vaksinohen kundër koronavirusit. Ndërkaq,

personat mbi 18 vjeç, që janë imunizuar me dy doza para tre muajsh, mund ta marrin edhe dozën përforcuese apo atë të tretë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se Omicroni po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë dhe është

varianti dominues në qarkullim. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën.

Shmangini udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e mbyllura. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha

rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. Prandaj, në vazhdimësi vlen për secilin person dhe më tej vazhdojmë të bëjmë thirrje: Mbulo gojën dhe hundën me maskë! Mbaj higjienën. Respekto distancën dhe vaksinohu", ka njoftuar IKShPK-ja.

Drejtori i 'Pfizer'-it: Më mirë një vaksinë e përvitshme për Covidin sesa doza të shpeshta përforcuese



PRISHTINË, 23 JANAR - Drejtori ekzekutiv i kompanisë "Pfizer Inc", Albert Bourla, ka thënë se një vaksinë vjetore për Covid-19 do të ishte e preferueshme në krahasim me doza të shpeshta përforcuese në luftën kundër pandemisë së koronavirusit. Vaksina e "Pfizer/BioNtech" për Covid-19 ka rezultuar efektive kundër rasteve të rënda dhe vdekjeve të shkaktuara nga varianti Omicron, por më pak efektive në parandalimin e transmetimit.

Me rritjen e rasteve disa vende kanë zgjeruar programet e dozave përforcuese të vaksinës Covid-19 ose kanë shkurtuar kohëzgjatjen mes injektiveve, ndërsa qeveritë përpiqen ta rritin mbrojtjen nga Covid-19.

Në një intervistë për televizionin "N12 News" të Izraelit, Bourla u pyet nëse ai parashikon që dozat përforcuese do të ofrohen rregullisht çdo katër deri në pesë muaj. "Nuk do të ishte një skenar i mirë. Unë shpresoj që të

kemi një vaksinë që do të duhet ta bëjmë një herë në vit. Një herë në vit është më e lehtë të bindësh njerëzit që ta bëjnë një gjë të tillë. Është më e lehtë për njerëzit që ta mbajnë mend. Pra, nga perspektiva e shëndetit publik, është një situatë ideale. Ne po përpiqemi të shohim nëse mund të krijojmë një vaksinë që jep mbrojtje nga Omicroni, por që është efektive edhe për variantet e tjera dhe kjo mund të jetë një zgjidhje", ka thënë ai.

Kjo javë fillon me acar edhe më të ashpër

Prishtinë, 23 janar - Acari që përfshiu vendin në këto ditë të fundjavës, vazhdon edhe në fillim të javës, madje edhe më i ashpër, ka parashikuar "Prishtina Weather". "Java fillon me acar edhe më të ashpër. Të hënën reshje të dobëta bore. Në pjesën e dytë të javës temperaturat në rritje, me vranësira. Ditën e premte sërish mundësi për

reshje bore dhe shiu. Të hënën priten mundësi edhe për reshje të dobëta bore. Dita e martë sjell kthjellime, e nga e mërkura do të ketë edhe vranësira dhe intervale me diell gjatë ditës, kur edhe temperaturat maksimale fillojnë të rriten. Ditën e premte priten mundësi për të reshura bore, e në vise më të ulëta edhe të shiut. Cilësia

e ajrit mbetet me indeks kryesisht në vlera të pranueshme ditën e hënë, mirëpo nga dita e martë periudhat më të zgjatura të qetësisë mbajnë ndotësit ajrorë më të përqendruar pranë sipërfaqes, që bën indeksin të kalojë edhe në vlera të dobëta apo të pashëndetshme", ka njoftuar "Prishtina Weather".





Rikthehet në funksion blloku B2 i Termocentralit “Kosova B”

Është rikthyer të dielën në funksion blloku B2 i Termocentralit “Kosova B”. KEK-u ka bërë me dije se pas përfundimit të punimeve sipas dinamikës së paraparë dhe pas testeve, njësia B-2 është duke prodhuar me kapacitet të plotë. Kryeministri Albin Kurti e ka mirëpritur rikthimin e këtij blloku, duke thënë se tani Kosova për çdo orë do t’i paguajë rreth 50 mijë euro import më pak. Ndërsa përfaqësuesit e opozitës i kanë kërkuar përsëri kryeministrit që të mos lejojë shtrenjtimin e rrymës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 JANAR - Korporata Energjetike e Kosovës ka njoftuar se pas përfundimit të punimeve sipas dinamikës së paraparë njësia prodhuese B-2 në Termocentralin “Kosova B” është aktivizuar. Që nga orët e para të së dielës kjo njësi është në kapacitete të plota të prodhimit dhe në gjendje stabile. “Korporata Energjetike e Kosovës ju njofton se pas përfundimit të punimeve sipas dinamikës së paraparë dhe pas

testeve të njëpasnjëshme që zakonisht realizohen pas një remonti të tillë, njësia prodhuese B-2 në Termocentralin Kosova B mbrëmë rreth orës 23:55 është sinkronizuar me rrjetin energjetik. Aktualisht njësia B-2 është duke prodhuar me kapacitet të plotë dhe gjendja e saj është stabile”, është thënë në njoftimin për medie të kësaj korporate.

Rikthimin e bllokut B2 të TC “Kosova B” e ka mirëpritur edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai ka thënë se prej vënies

në funksion të këtij blloku Kosova për çdo orë do t’i paguajë rreth 50 mijë euro import më pak. “Rreth 200 euro kushtoi 1 MWh në bursën ndërkombëtare të energjisë dje, mirëpo sot në orën 10:15 u kthye në punë blloku B2 i TC ‘Kosova B’, me fuqi 245 MW. Sinkronizimi është bërë mbrëmë në orën 23:55. Gjendja e turbinës është e mirë dhe nuk ka pasur nevojë për balancim. Me fjalë të tjera, për çdo orë do t’i paguajmë rreth 50 mijë euro import më pak, e deri nesër në mëngjes rreth 1,2 milion euro më pak se gjatë ditëve të javës që

po lëmë pas. Ky është lajm shumë i mirë për të gjithë neve. Eh sikur ta kishim tash TC ‘Kosova A’ të rindërtuar nga Bilfingeri gjerman dhe blloqet B3 dhe B4 me nga 300 MË fuqi secila!”, ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në “Facebook”. Ndaj komentit të kryeministrit ka reaguar kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se kryeministri Kurti nuk është në atë pozitë për të vajtuar, por për të gjetur zgjidhje. Ai ka kërkuar nga kryeministri që të mos lejojë shtrenjtimin e energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës. “Lajmi i ditës do të ishte ‘nuk do të ketë shtrenjtimit të rrymës në Kosovë’ e jo u rikthye në prodhim Blloku B! Nuk është hera e parë që bie e rikthehet ky bllok. Kryeministri i paska bërë disa pyetje hipotetike: Eh sikur ta kishim të renovuar Kosovën A...eh sikur t’i kishim blloqet B-3, B-4... eh

sikur...Po paska harru të thotë: Eh sikur të mos e kisha bllokuar projektin ‘Kosova e Re’; eh sikur të mos e kisha refuzuar gazin amerikan. Po e shkuara është e shkuar. Ai nuk është aty për të vajtuar por për të gjetur zgjidhje. Kryeministër mos e shtrenjto rrymën, e lëri retorikat”, ka shkruar Haradinaj. Kritika për qeverinë ka shprehur edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi. Sipas tij, kjo qeveri humbjet e qytetarëve po i promovon si fitore. “Paaftësia qeverisëse, humbjet e qytetarëve i promovon si fitore, gjersa feston në emër të suksesit imagjinar. Edhe një javë shtesë me rezultat të dobët. Nga paaftësia qeverisëse po sfidaohet dhe dëmtohet mirëqenia e qytetarëve, ndërsa hallet e problemet e tyre vetëm sa shtohen përditë e më shumë. Paaftësia qeverisëse, zgjidhjet e problemeve i ka të thjeshta ‘Shto një problem për të shuar

DASH: Kosova dhe Serbia të kenë prioritet dialogun

PRISHTINË, 23 JANAR - Shtetet e Bashkuara u bëjnë thirrje Kosovës dhe Serbisë të angazhohen në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në "frymën e kompromisit të nevojshëm", që të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e raporteve. "Ne vazhdojmë t'u bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë që ta kenë prioritetet dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, të punojnë për zvogëlimin e tensioneve dhe t'i ndjekin negociatat me fleksibilitet dhe në frymën e kompromisit të nevojshëm për të arritur një marrëveshje normalizimi gjithëpërfshirëse që do të mundësojë rrugën e tyre përkatëse evropiane", tha për "Radion Evropa e Lirë" një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit. Këtë përgjigje DASH-i e dha

duke iu përgjigjur pyetjeve të REL-it për një raport të publikuar së fundmi nga Instituti për Politika të Jashtme i Universitetit "Johns Hopkins" (SAIS) dhe Qendrës Wilson, që ia rekomandonte administratës amerikane vendosjen e sanksioneve për politikanët e Kosovës dhe Shqipërisë që me deklaratat e tyre promovojnë bashkimin e të dyja shteteve. "Ne e vlerësojmë këndvështrimin akademik dhe të organizatave për këto çështje. Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për një Kosovë sovranë, të pavarur, shumetnike, siç parashihet në Kushtetutën e saj", tha zëdhënësi i DASH-it, duke mos e komentuar këtë raport. Një nga kontribuuesit në raportin e titulluar "Nga kriza në konvergencë - Strategjia për të trajtuar paqëndrueshmërinë

dhe burimin e saj në Ballkan", Lulzim Peci, tha për "Radion Evropa e Lirë" se e sheh si mundësi reale që ShBA-ja t'i sanksionojë politikanët që promovojnë "bashkimin" e Kosovës dhe Shqipërisë. "Në një të ardhme të afërt, nëse aktorët kryesorë politikë nuk i ndryshojnë qëndrimet e tyre politike, unë mendoj se ky opsion është shumë real sepse, praktikisht, një retorikë e tillë e pengon stabilizimin e Ballkanit, por edhe arritjen e zgjidhjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", tha Peci. Por, vendosja e sanksioneve për këtë çështje nuk duket si masë reale për njohësin e çështjeve politike, Agon Maliqi. "ShBA-ja nuk e ka praktikë të sanksionojë opinione. Në raste të tilla praktikohet shmangia e vizitave ose izolimi politik", tha Maliqi për "Radion Evropa e Lirë".

Së fundmi, Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sanksione ndaj politikanëve në Ballkanin Perëndimor lidhur me dyshimet për përfshirjen e tyre në korrupsion. Në maj të vitit 2021 ish-presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha, u shpall "persona non grata" (person i padëshiruar) për shkak të, siç tha Uashingtoni, përfshirjes në korrupsion të gjerë. Ndërkaq, më 5 janar 2022, ShBA-ja zgjeroi sanksionet ndaj anëtarit serb të Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës, Millorad Dodik, për përfshirje në korrupsion dhe minimin e stabilitetit të Bosnjës dhe rajonit. Zëvendësndimëssekretari për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, njëherësh i dërguari i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Gabriel

Escobar, ka paralajmëruar se ShBA-ja do të sanksionojë edhe politikanë të tjerë në këtë rajon. DASH-i tha se ShBA-ja është e përkushtuar për suksesin e mbarë rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe integrimin e këtyre shteteve në BE, përfshirë edhe Kosovën "si shtet i pavarur, sovran dhe demokratik". "Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të përkushtuara në të gjitha nivelet për suksesin e rajonit dhe zëvendësndimëssekretari për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, njëherësh i dërguari i posaçëm për Ballkanin Perëndimor [Gabriel Escobar], së bashku me ambasadorët e ShBA-së në Prishtinë dhe Beograd, mbeten bashkëbiseduesit kryesorë të ShBA-së për këto çështje", tha një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit.



një tjetër'. Kjo terapi politike e ka origjinën te qeveritë e paafta dhe popullsite, të cilat nuk ndalen me qas, ngaqë fillojnë një fushatë të egër arsyetuese dhe fajësuese ndaj të gjithëve. Në shumë raste i fajësojnë edhe qytetarët, pastaj vazhdojnë me propagandën e suksesit imagjinari, duke i mohuar të vërtetat e prekshme dhe të

dëmshme, të jetueshme dhe reale", ka shkruar Gashi në profilin e vet në "Facebook". Më tej, ai ka vlerësuar se me këtë qeveri qytetarët do ta paguajnë faturën e energjisë elektrike për 300 për qind më shtrenjtë. "Kulmin e padrejtësisë e arrijnë kur humbjet e qytetarëve i promovojnë si fitore, gjersa

festojnë në emër të suksesit imagjinari. E papranueshme. Krejt e padrejtë. Sepse nuk mund t'u thuash qytetarëve: urime për rritjen e çmimeve! Apo, gëzohuni se tash e tutje do të keni mundësi të blini e të ushqeheni më pak. Nuk mund t'u thuash qytetarëve: vlerësoni pozitivisht faktin që do ta paguani faturën e energjisë

elektrike për 300 për qind më shtrenjtë. Apo vlerësoni pozitivisht faktin se do të ngrohni më pak e do ta paguani më shumë, ndërsa ju prodhues do të punoni më pak ose aspak", ka shkruar Gashi. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka propozuar rritje të çmimeve të energjisë. Qeveria e Kosovës është zotuar t'i ndajë 75 milionë

euro për subvencionimin e faturave të energjisë. Opozita ka kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë, madje subjektet opozitare kanë kërkuar të miratohet një rezolutë në Kuvend për ta kundërshtuar çmimin e energjisë. Të shtunën është paralajmëruar edhe protestë për të kundërshtuar këtë rritje.

Dy shkolla në Kamenicë vazhdojnë mësimin online

KAMENICË, 23 JANAR (ER) - Për shkak të numrit të madh të nxënësve të infektuar me Covid-19, si dhe personelit shkollor, në harmoni me

udhëzuesin për organizimin e procesit mësimor në kushtet e pandemisë, i hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

(MASHTI), duke aplikuar skenarin C për mësimin online dhe rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të

Kosovës (IKShPK), shkollat: “Dëshmorët e Kombit” dhe “Fan S. Noli” nga e hëna do ta zhvillojnë mësimin në formën online deri në

përmirësim të gjendjes. “Ju lutem, respektoni rregullat e Institutit. Mbroni veten dhe të tjerët”, ka njoftuar komuna e Kamenicës.

78 për qind e punonjësve në komunën e Prishtinës janë vaksinuar me dy dozat kundër Covidit

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka mbajtur mbledhjen e shtabit emergjent për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Në këtë mbledhje u diskutua vendimi i fundit i Qeverisë së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë.

Në këtë mbledhje është marrë vendim që të organizohet puna vetëm me staf esencial. “Të gjithë punonjësit e komunës së

Prishtinës, ndërmarrjeve publike lokale, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e mëposhtme, në mënyrë që t’ju lejohet hyrja në ambientet e punës: 1. Çertifikatën e vaksinimit me më së paku dy doza kundër Covid-19; 2. Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës se kanë kundërrindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ për Covid-19 jo më të vjetër se një javë”, ka njoftuar

komuna e Prishtinës.

Sipas këtij njoftimi, administrata është e obliguar të caktojë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjëres nga dëshmitë e cekura më lart. “Gjithashtu, dëshirojmë të ju informojmë, se sipas të dhënave të fundit që kemi mbledhur, 78 për qind e punonjësve tanë janë të vaksinuar me dy doza, 15 për qind me një dozë, kurse 7 për qind në proces të vaksinimit”, ka njoftuar komuna e Prishtinës.



Rrugët në qytetin e Mitrovicës dhe fshatrave përreth, të kalueshme



MITROVICË, 23 JANAR (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në komunën e Mitrovicës, Bahtir Maxhuni, ka inspektuar situatën e përgjithshme në rrugët e qytetit të Mitrovicës pas reshjeve të borës. Me këtë rast, drejtori Maxhuni ka theksuar se shumica e rrugëve janë të kalueshme, ndërkohë që ka intervenime të pandërprera të kompanive

për mirëmbajtjen e rrugëve, sidomos në zonën e Shalës së Bajgore për shkak të telasheve që paraqiten si pasojë e erërave të forta që mbretërojnë atje. “Ndonëse në qytet të gjitha rrugët janë të pastruara, në viset rurale ende kemi borë, sidomos në rajonin e Shalës së Bajgore ku kemi pasur intervenime më të shpeshta dhe janë hasur disa vështirësi në qarkullim si pasojë e

fërfëllizës që mbretëron atje, por aktualisht shumica e rrugëve janë të kalueshme”, ka thënë drejtori Maxhuni. Kompanitë e kontraktuara kanë intervenuar në Trepçë, Stan Tërg, Melenicë, Vllahi, Bajgorë, Zabërgjë, Tërstenë, Mazhiq, Rashan, Kovaçicë. Komuna e Mitrovicës bën thirrje te të gjithë vozitësit që të jenë të pajisur me pajisje dimërore dhe të kenë kujdes të shtuar gjatë vozitjes.

“Islamic Relief Kosova” ndihmon familjet nevojtare në Gjilan me 150 pako ushqimore

GJILAN, 23 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka falënderuar organizatën “Islamic Relief Kosova” e cila ka ndihmuar familjet në nevojë përmes një donacioni për Qendrën për Punë Sociale. Me këtë rast, Hyseni ka falënderuar donatorin për këtë kontingjent ndihmesh, duke rikujtuar se kjo organizatë humanitare mbështet në

vazhdimësi nevojtarët e komunës së Gjilanit.

Kryetari Hyseni, i cili ka marrë pjesë në procesin e dorëzimit të pakove ushqimore, ka thënë se shpërndarja është bërë nga Qendra për Punë Sociale, sipas listës së prioriteteve. “Konfirmojmë se të gjitha paketat janë shpërndarë në kuadër të prioriteteve që komisioni i ka për rastet

sociale dhe një falënderim i veçantë shkon për këtë organizatë bamirëse e cila vazhdimisht mbështet komunën tonë me donacione të ndryshme”, ka thënë kryetari Hyseni.

Ky ishte një kontingjent prej 150 pakove ushqimore nga “Islamic Relief Kosova”, që Qendra për Punë Sociale në Gjilan i shpërndau për familjet në nevojë.



Në 24 orët e fundit në Malishevë dy të shëruar dhe 12 raste të reja me Covid



MALISHEVË, 23 JANAR (ER) - Në 24 orët e fundit në territorin e komunës së Malishevës dy persona janë shëruar nga Covid-19, ndërsa janë regjistruar 12 raste të reja. Kjo është bërë me dije nga ana e IKShPK-së, ITRShP-së në Prizren dhe QKMF-së

në Malishevë, në komunikim të rregullt me shtabin emergjent për menaxhimin e situatës me Covid-19 në komunën e Malishevës si dhe nga komunikimi me rastet në terren.

Gjendja e përgjithshme me

pandemi në komunën e Malishevës është kjo: Nga paraqitja e rastit të parë më 14 mars 2020 e deri më sot me Covid-19 janë regjistruar gjithsej 2 909 raste, prej tyre 2 737 janë shëruar, 85 kanë vdekur dhe aktiv me Covid janë 87 raste.

Me zanat e pa punë



PRISHTINË, 23 JANAR - Leonit Balaj nga fshati Dobërdelan i Suharekës ka dy vjet që ka përfunduar mësimet në Shkollën Profesionale "Skënder Luarasi" në këtë komunë. Balaj, 19 vjeç, ka kryer drejtimin e informatikës, por nuk ka arritur të gjejë punë. "Në fillim na ka ndihmuar shkolla. Kemi pasur kontrata me biznese të ndryshme. Kam punuar, kam mbajtur praktikë, por tash jam i papunë. Po shikoj të gjej diçka që të punoj", thotë Balaj për "Radion Evropa e Lirë".

Ai thotë se në komunën e Suharekës, e cila ka rreth 60 000 banorë, tregu është i vogël dhe se nuk ka pasur oferta për profesionin e tij. "Përderisa ne po bëjmë praktikë, po shkollohem për këtë punë, do të ishte mirë që shteti dhe komuna të na ofrojnë punë për këtë që kemi mësuar e jo të rrimë. Nëse gjej punë rri [në Kosovë], por nëse jo, më duhet të dal jashtë vendit", thotë ai.

Në të gjitha komunat e Kosovës janë më shumë se 37 mijë nxënës që ndjekin mësimet në shkolla profesionale, prej tyre më shumë se 21 mijë janë djem dhe më se 15 mijë janë vajza. Sipas një hulumtimi të organizatës ETEA, që merret me arsimin në Kosovë, vetëm 11.4 për qind e nxënësve në vitin 2021 kanë arritur të punësohen pas përfundimit të shkollës profesionale, ndërsa 88.6 për qind nuk e kanë pasur një mundësi të tillë.

Velsa Shabani, hulumtuese në këtë organizatë, thotë se hulumtimi është bërë për të kuptuar se përse po rritet numri i të papunëve.

Në muajin dhjetor, nga Agjencia e Kosovës për Punësim, kanë bërë me dije se numri i përgjithshëm i punëkërkuësve të regjistruar në këtë zyrë është 120 mijë. Sipas të dhënave të agjencisë, vetëm gjatë vitit 2021 rreth 12 000 persona janë regjistruar si të papunë.

Velsa Shabani thotë se rezultati i hulumtimit të organizatës së saj është "alarmant". "Këta nxënës mund të vazhdojnë edhe në fakultet, por qëllimi kryesor i shkollës profesionale është që këta të rinj të punësohen. E përderisa kjo nuk po arrihet, ne kemi gjetur se ngecjet për këtë shifër kaq të madhe janë mospërshtatja e profileve dhe cilësia e arsimit", thotë Shabani. Fokus i hulumtimit, sipas saj, kanë qenë drejtimet: informatikë, arkitekturë dhe telekomunikacion.

Drejtori i Shkollës Profesionale "Skënder Luarasi" në Suharekë, Hamdi Bytyqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nga rreth 700 nxënës sa ka kjo shkollë në katër drejtime: Makineri, Elektro, Ndërtimtari dhe Rrobaqepësi, çdo vit punësohen më shumë se 100 nxënës të diplomuar. "Nuk ka nxënës që ka kryer drejtimin si instalues elektrik e që nuk është punësuar ose vetëpunësuar. Edhe nga Drejtimi i Instaluesve të Ngrohjes ka një numër të madh të nxënësve që janë punësuar. Është një ndjenjë e mirë kur shohim vajzat e Drejtimin të Rrobaqepësisë të gjitha të punësuar nëpër rrobaqepësi të ndryshme", thotë Bytyqi. Sipas tij, drejtimet në shkollë përshtaten në bazë të kërkesave të tregut.

Mirëpo ndryshe thonë disa përfaqësues të bizneseve në Kosovë të cilët ankohen për, siç thonë, problemin e gjetjes së punëtorëve të kualifikuar.

Nezir Sejdiu nga Klina është pronar i kompanisë "Ginza" që merret me prodhimin e dyerve dhe të dritareve të plastikës dhe të aluminit. Ai thotë se për 16 vjet të ekzistencës së kompanisë së tij pjesa më e vështirë ka qenë gjetja e punëtorëve të kualifikuar. "Nuk ka saldues... asnjë profil nuk mund ta gjejmë në nivelin e mesëm të shkollimit, që kur të hyjë në prodhim, të paktën ta dijë se çfarë janë makinat e prodhimit, si të mbrohet në vendin e punës", thotë Sejdiu.

Për të aftësuar një mjeshtër ai thotë se i duhen dy-tre vjet kohë. "Të kualifikuar nuk gjej fare. E kam hequr si kriter edhe nga konkursi që të gjej punëtorë që kanë kryer shkollë. Jemi shndërruar vetë në njëfarë shkolle. I trajnojmë dhe i mësojmë vetë, e që po na merr shumë kohë dhe ka kosto. Pastaj, pas një kohe, të njëjtit edhe po na e lëshojnë punën dhe shumica po shkojnë jashtë", thotë Sejdiu, kompania e të cilit aktualisht ka 38 punëtorë.

Shqetësime të ngjashme, sipas kryetarit të Odës së Afarizmit në Kosovë, Skënder Krasniqi, kanë edhe shumë biznese të tjera. Sipas tij, shkollat profesionale nuk i plotësojnë kriteret e aftësimin profesional në bazë të nevojave të tregut. "Në përgjithësi, prodhimi është në shpërputhje me kërkesën e tregut. Asnjëherë në Kosovë institucionet nuk i kanë bërë analizë tregut se për çfarë ka

nevojë, por vetëm kanë prodhuar, pa marrë parasysh a ka pasur nevojë. Të rinjtë po vazhdojnë të kryejnë shkolla dhe fakultete dhe të mos jenë të aftë për punë dhe të mos e gjejnë veten në treg të punës", thotë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Shqetësime të ngjashme, sipas kryetarit të Odës së Afarizmit në Kosovë, Skënder Krasniqi, kanë edhe shumë biznese të tjera. Sipas tij, shkollat profesionale nuk i plotësojnë kriteret e

aftësimin profesional në bazë të nevojave të tregut. "Në përgjithësi, prodhimi është në shpërputhje me kërkesën e tregut. Asnjëherë në Kosovë institucionet nuk i kanë bërë analizë tregut se për çfarë ka nevojë, por vetëm kanë prodhuar, pa marrë parasysh a ka pasur nevojë. Të rinjtë po vazhdojnë të kryejnë shkolla dhe fakultete dhe të mos jenë të aftë për punë dhe të mos e gjejnë veten në treg të punës", thotë Krasniqi.

Cili është roli i Ministrisë së Arsimit?

Në një përgjigje me shkrim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MASHTI), dërguar "Radios Evropa e Lirë", thuhet se profilet e shkollave përditësohen përmes grupeve punuese, ku anëtarë janë edhe përfaqësuesit e tregut të punës. "MASHTI planifikon të jetë më i hapur ndaj bizneseve dhe ta fuqizojë bashkëpunimin ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve, sepse arsimit dhe aftësimin profesional nuk mund të funksionojnë pa përfshirjen e bizneseve", thuhet në deklaratë.

Rinor Qehaja, ekspert i fushës së arsimit në organizatën "Ed-Guard", thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk ka përputhje të kërkesave të tregut me profilet e studimeve qoftë në shkollat e mesme

profesionale, qoftë në universitete. Sipas tij, nevojitet një strategji kombëtare që do t'i orientonte të rinjtë në profilet e studimeve që gjenerojnë punësim. "Kjo strategji, e zhvilluar nga nevojat e biznesit, do të shërbente edhe si udhërrëfyes për institucione të arsimit, për profile me interes për studentin, që nxitin regjistrimin dhe mundësojnë punësimin. Është e rëndësishme që të ketë një koordinimin ndër-institucional, pra një komunikim të strukturuar institucional, të dihet profili i të papunëve dhe çfarë duhet të jetë përgjigja institucionale karshi kërkesës së tregut për punë", thotë Qehaja.

Në vitin 2021 shkalla e papunësisë në Kosovë ka qenë rreth 26 për qind. Krahasuar me vitin paraprak, ka pasur rritje për 0.8 për qind.

Vrasja e mbrojtësve të Sanxhakut, Aqif Blytës dhe Ahmet Dacit: Nuk do të më harrojnë fëmijët e Pazarit të Ri



Nga: Ismet AZIZI

Pas ndërprerjes së sulmeve çetnike ndaj Pazarit të Ri (Novi Pazar), në fund të vitit 1941, u rrit aktiviteti i komunistëve në Sanxhak. Ndërkohë ishte formuar Milicia Vullnetare Popullore Myslimane. Formimi i kësaj milicie nisi në gjysmën e dytë të vitit 1941, si kundërpërgjigje ndaj masakrave çetnike të popullsisë joserbe në fund të vitit 1941 e në fillim të vitit 1942, dhe kishin për qëllim mbrojtjen e fshatrave të banuar me shqiptarë dhe boshnjakë nga njësitë çetnike, por edhe nga ato partizane. Harun Crnovrshanin thekson: "Mund të thuhet me siguri të madhe se ata ishin garantues të mbijetesës së popullsisë myslimane (shqiptare e boshnjake). Më vonë, përveç formimit të Milicisë Myslimane, e cila përbëhej nga vullnetarët, shqiptarë e boshnjakë, në vitin 1943 gjermanët formuan të ashtuquajturën shuq-policinë të cilën e komandonte Biko Dresheviq. Ajo ishte shumë mobile dhe, përveç që mbrojtje Pazarin e Ri nga sulmet çetnike, arriti të ruajë edhe popullatën e Peshterit nga tendencat e çetnikëve për t'i shfarosur". Por, në kohën kur po afrohej

përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe ushtria gjermane po pësonte humbje në të gjitha frontet, Milicia Myslimane në Sanxhak përjetoi fundin e saj. Megjithatë, vazhdoi të rezistojë. Kah fundi i viti 1944 janë zhvilluar luftime të ashpra me partizanët, të cilat ishin nisur për ta mposhtur Milicinë Myslimane. Divizionet partizane kah fundi i viti 1944 u futen thellë në Sanxhak dhe i shkaktuan humbje pjesëtarëve të kësaj milicie në të gjitha qytetet kryesore. Në ditët e para të gushtit të viti 1944, partizanët e Peko Dapçeviqit hynë në Sanxhak, nga Mali i Zi, dhe në malet e Rogoznës dhe në Llukarë në afërsi të Pazarit të Ri, arritën t'i vrasin 200 ushtarë shqiptarë (xhandarë). Për shkak të përqendrimit të madh të gjermanëve në Pazar të Ri, forcat aleate bombarduan qytetin tre herë, ku u vranë 600 gjermanë dhe mbi 2000 myslimanë (shqiptarë e boshnjakë). Në të njëjtën kohë partizanëve iu bashkuan çetnikët e rrethinës të cilët kishin rrethuar qytetin, ndërsa gjermanët dhe Milicia Myslimane u tërhoqën në drejtim të Senicës, ndërsa një grup i luftëtarëve, në mesin e tyre edhe Aqif Blyta, Hasan Zvizdiqi, vëllezërit Dreshaj, u

larguan në drejtim të Kosovës, Greqisë dhe Shqipërisë. Pas konsolidimit të pushtetit komunist, partizanët ekzekutuan elitën e Pazarit dhe viseve tjera të Sanxhakut. Trupat e varur dhe të ekzekutuar partizanët i kanë hedhur në gropat të krijuara nga bombardimet e forcave aleate. Të nesërmen, në qytet i publikonin listat e të zhdukurve të cilët pushteti i cilësonte si armiq të popullit. Për t'i humbë gjurmët, këtë lagje e shndërruan në lagje banimi. Prej tetorit të vitit 1944 komunistet mbajtën një regjistër të atyre që morën dënime të rënda, përfshirë edhe dënimin me vdekje. Emrat e martirëve të vrarë mund të gjenden në listat e regjistruara në të ashtuquajturat gjyqet e popullit. Dënimet e tilla me vdekje në fakt diktoheshin nga Partia Komuniste, teksti i kalohet UDB-së dhe lexohej ne gjykatë vetëm për të krijuar përshtypjen e një gjykimi të drejtë demokratik. Funkcionari i regjimit komunist, në atë kohë SKOJ-ist (LRKJ-së, anëtar i Lidhjes së Rinisë Komuniste të Jugosllavisë), Ramiz Crnishanin, në veprën e tij "Priče iz tiješne čaršije" ("Tregime nga çarshia e ngushtë"), në të cilën arsyeton shumë veprime të këqija të

regjimit komunist, lidhur me krimet në Haxhet, lagje e Pazarit të Ri, ndër të tjera, thotë: "Përderisa isha i shtrirë në shtrat nga sëmundja, gjatë natës kam dëgjuar krisma, të cilat vinin nga Haxheti. Ishin krisma nga ekzekutimi i armiqve të popullit ... vendimet për jetë dhe vdekje i ndërmerrnin individët. Posaçërisht në zë të keq ishte Gjorgje Ostojiq (Peruninçiq), major i OZN-ës ... por, si duket nuk e kishte ndërgjegjeje e pastër as Voja Lekoviq, sepse disa herë më ka pyetur se mos ata atëherë e kanë tepruar me ato ekzekutime?!". Gjatë netëve të errëta e të ftohta të viteve 1944-1946, të dënuarit me vdekje nxirreshin nga qelitë, ngarkoheshin në kamion dhe dërgoheshin në vendet e braktisura. Gjatë luftës antifashiste në këtë krahinë ishte zhvilluar një luftë e drejtë antifashiste, ku dalloheshin shqiptarët dhe boshnjakët, por, me të mbaruar lufta, politikanët e Serbisë dhe Malit të Zi do të bëjnë pazare dhe do ta ndajnë këtë trevë ashtu si provuan ta ndajnë edhe Kosovën. Ndarja ngjau me fajn e faktorit të brendshëm, por edhe në sajë të raportit të forcave politike dhe ushtarake. Edhe pse pritej që trupat partizane të futen në Pazarin e

Ri, Aqif Blyta, megjithatë, siç tregojnë dokumentet e kohës, nuk hoqi dorë nga rezistenca e armatosur kundër partizano-çetnikëve serbë. Sipas Emin Fazlisë, Blyta merr pjesë aktive në Mbledhjen e Komitetit Qendror të LNDSH-së, të mbajtur në ilegalitet të thellë në Prizren, më 28 nëntor të vitit 1944, pikërisht në ditën kur trupat partizane e çetnike futen në Pazarin e Ri. Ky tubim i KQ të LNDSH-së mori këto vendime programore instruktive, politike dhe ushtarake. "Tani ngadalë, por sigurt, Drenica po bëhej qendër e luftës për liri. Mandej, Lëvizja NDSH do të shtrihet edhe në rajonin e Maqedonisë, ku shqiptarët janë në trojet e veta, dhe do të drejtohet nga Komiteti i Shkupit. Që të dy Komitetet edhe ai i Kosovës me qendër në Prizren, do të bëjnë betimin dhe do të pajtojnë programin politiko-ushtarak". Ne realizimin e Programit të luftës për Shqipërinë Etnike, në Shalë të Bajgorës kishte filluar te rekrutoheshin anëtarët e rinj të LNDSH-së, sikurse edhe ne territorin e Zveçanit. Në Shalë të Bajgorës vepronte një Nënkomitet i LNDSH-së, i cili drejtohej nga Bislim Bajgora dhe Haradin Fazliu – Vidishiqi. Në krye të Komitetit për rrethin e Mitrovicës ishte ende Ibrahim

Lutfiu, mik i ngushtë i Aqif Blytës

Për bëmat e partizanëve pas marrjes së pushtetit në Sanxhak shkruan H Çengiq: "Kur çetnikët ndërprejnë therjen e popullit, filluan partizanët të qërojnë hesapet me popullin mysliman të Sanxhakut. Ata vranë të arsimuarit, elitën kombëtare, ata të cilët nuk pajtoheshin me ideologjinë komuniste,... i merrnin zakonisht gjatë natës, i "gjkonin", i dënonin dhe ekzekutonin,... u dënuan vetëm s kishin luftuar kundër hordhive çetnike,... Çetnikëve iu falën të gjitha mëkatet, sepse në vitin 1944 i amnistuan por jo edhe të tjerët.

Në këtë kohë, krahas arrestimeve, burgosjeve dhe vrasjeve, komunistët jugosllavë po zhvillonin edhe një luftë të ashpër kundër gjuhës shqipe, sipas raportit të CIA-s. "Pushuesit e rinj pretendonin se gjuhës shqipe i mungonin termat adekuate dhe, si rrjedhojë, është e pamundur që të përdoret në rrethana të reja". Si rezultat, serbët u përpoqën t'i bindin shqiptarët se ekzistenca e shqipes në vendet ku përdorej serbishtja ishte e pavlerë, pasi që shqiptarët kuptonin serbisht. Pse mos të konkludojmë se sukses më të madh apo edhe të plotë pati tek popullata shqiptare e Sanxhakut, sidomos ajo e Peshterit dhe krahinës së Rozhajës".

Sipas Hatixhe (Çarovac) Nikshiqit, "gjatë rrugës, duke u larguar nëpër Kosovë, Aqif Blyta, në momentet e fundit, ndërton mendjen dhe vendos të kthehet në Pazar. Ai u drejtohet Dreshajve: 'Unë do të kthehem në Pazarin e Ri, le të bëhet si të

bëhet!' 'Mos Aqif, do të vrasin komunistët!', i kishte thënë Biko. 'Nëse jam fajtor, le të më vrasin, unë nuk ndihem fajtor, as para Zotit, as para popullit!' Ishin fjalët e fundit që i kishin shkëmbyer Aqif Blyta dhe Bik Dreshaj me rastin e ndarjes nga bashkëluftëtarët. Ata ishin larguar në drejtim të Greqisë. Para se të kapet nga komunistët, Aqifi u strehua tek të afërmit e bashkëshortes së tij, në familjen e Kumani, ku, pasi ishte zbuluar, kishte ardhur personalisht Ali Shukriu për ta arrestuar. Ishte i armatosur. Në dorë mbante granatën, por, për shkak se në shtëpinë ku ndodhej, ishin edhe motra e tij, Azizja, me pesë djemtë e saj dhe të bijën, Veziren, nuk ndërmori asgjë, pra nuk rezistoi. Në shenjë keqardhjeje, Ali Shukriu i drejtohet Aqifit me këto fjalë: 'Po edhe ty duhet të të dorëzoj?' Aqifi nuk ndihej fajtor. 'Nuk do të më harrojnë fëmijët e Pazarit', ishin ndër fjalët e tij fundit!"

Pasi ishte mbajtur në arrest 21 ditë bashkë me Ahmet Dacin, Peruniçiq merr vendim për ta ekzekutuar. Ky kriminel më vonë është dënuar si informbyroist dhe në rrugë për në Goli Otok ka bërë vetëvrasje duke kërcyer nga treni.

Gjatë qëndrimit në burg, kriminelët komunistë i kanë munduar shumë Aqif Blytën e Ahmet Dacin. Jo vetëm që i kanë rrahur, por edhe ua kanë shkukur thonjtë e gishtave të duarve e këmbëve.

"Kur nëna ime ia ka ndërruar teshat dhe çarçafët, asnjëherë nuk ka mundur t'i pastrojë si duhet, prandaj nuk ua ka dërguar më. Gjithherë është dashur çarçafë të tjerë, pra të

reja. Në burg me ta kanë qenë edhe Nazim Kovraiqi, i cili ka shpëtua, Huzeir Ljaiq, gjithashtu, mandej Sulejman Beg Rasovac, të gjithë njerëz me nam. Para se ta ekzekutojnë, Aqifit i kanë dhënë injeksion, prandaj nuk ka mundur ta thotë asnjë fjalë. Kur djaloshi, i cili ka shërbyer te ne, i ka sjellë çarçafët dhe batanijet nga burgu, me atë rast nëna ime kur ka vërejtur njollat e gjakut dhe të plagëve, ka tentuar të bëjë vetëvrasje, por të afërmit e kanë evituar. Të nesërmen, Haitxhja, motra e Aqifit mbledh fuqinë dhe, me hafiz Muharrem Kaçaporin, kanë shkuar në Haxhet për ta vizituar vendin ku i kishin hedhur kufomat në gropë. E gjetën kufomën e Aqifit, pothuajse krejtësisht të zhveshur, sepse paraprakisht, para se ta ekzekutonin, nuk i kishin lënë pothuajse asgjë në trup. Ia kishin plaçkitur orën e dorës, rrobat madje, edhe këpucët ia kishin zbatuar. E mbuluan kufomën, e kryen ritualin e varrosjes sipas rregullave fetare, ndërsa me të shpejt u detyruan të largohen, për shkak se pushtetarët, për të penguar ritualin fetar, i kishin provokuar duke i gjuajtur me armë nga ndërtesa e burgut. Pushteti komunist, jo vetëm që e vrau Aqif Blytën, por edhe ia konfiskoi tërë pasurinë, e keqtrajtoi fizikisht e psikikisht bashkëshorten e tij, e cila dikur ishte zonja e parë e qytetit. Ajo përfundoi si rast social dhe vdiq në vitin 1982!" thotë, ndër të tjera Hatixhe – Hatka (Çarovac) Nikshiq.

Mbas torturave mizore, që ia bënë OZN-a jugosllave atij dhe bashkëpunëtorit të tij më të

ngushtë, Ahmet Dacin, publikisht para masës popullore të sjellë gjithashtu me dhunë, ata i ekzekutojnë në Haxhet (lagje e sotme e Pazarit të Ri) më 21 janar 1945. Aqif Blyta, ndër të tjera, sipas vendimit të Komisionit shtetëror për përcaktimin e krimeve të okupatorit dhe ndihmësve të tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore, është akuzuar për bashkëpunim me pushtuesit gjermanë, për lidhje me Komitetin Kombëtar Shqiptar nga Kosova dhe Dukagjini me ndihmën e të cilit veprimi në drejtim të bashkimit të qarkut të Dezhëvës (Pazar të Ri), Shtavicës (Tutin) dhe atë të Senicës me Shqipërinë, mandej për vrasje masive, dëbimin dhe plaçkitje të popullsisë ortodokse, për pjesëmarrje dhe organizim të policisë myslimane dhe në trupat SS në trevën e Pazarit të Ri, si dhe për rifutjen e nametit (feudalizmit) për serbët. Në aktakuzë gjithashtu shkruan sa Blyta udhëhoqi me një trupë të caktuar, që quhej Shtab për shpërnguljen e Serbëve.

Me aktvendimin e gjykatës së divizionit ushtarak të krahinës së Sanxhak, nr. 6 e 19 janar 1945, Blyta u dënua me vdekje. Autoritetet ushtarake fillimisht kërkuan varje publike, por ai vendimi ishte revokuar dhe Blyta ekzekutohet. Insistohej që ekzekutimi të jetë publik dhe ai është kryer më 21 janar 1945, në ora 11,00, në Pazar të Ri. Shumica e njerëzve në Sanxhakë dinë se Aqif Effendiu u pushkatua nga partizanët në kodrën e Haxhit në Novi Pazar më 21 janar 1945, së bashku me 1500 boshnjakë të tjerë. Trupat e tyre u hodhën në gropat e mëdha të krijuara nga bombat e

avionëve aleatë gjatë bombardimeve të Novi Pazarit në nëntor 1944. Për të fshehur krimin e tyre, komunistët pas luftës ndërton një vendbanim mbi këto gropat! Nga të gjithë, vetëm Aqif Effendiu dhe Ahmet Daca u qëlluan publikisht për të frikësuar popullatën. Për këtë krim nuk lejohej të flitej e aq më pak të shkruhej. Ekzekutuesit komunistë i vendosën eshtrat e Aqif Effendiu dhe të viktimave të tjera thellë nën themelet e ndërtesës së kuqe "Musala" dhe shtëpive private që ndodheshin përballë spitalit të qytetit.

Populli i Sanxhakut mblodhi fuqinë dhe rehabilitoi Aqif Blytën, i cili përfaqëson njërin ndër personalitet më të ndritura të Sanxhakut. Populli e bëri këtë hap nëpërmjet përfaqësuesve të vet në Këshillin Kombëtar Mysliman të Sanxhakut, më 11 maj të viti 1991. Por, pushteti aktual ende, edhe pse i rehabilitoi të gjithë ata që ishin përfshirë në Luftën e Dytë Botërore, tashmë edhe D Mihailoviçin, lënda e Aqif Blytës ende ndodhet e pazgjidhur nga organet gjyqësore. Prokurori i lartë publik në Novi Pazar, qysh në fillim të viti 2015 ka sugjeruar që procesi rehabilitimit të Aqif Blytës, paraprakisht ligjrisht duhet të konstatohet vdekja. Këshilli Kombëtar Boshnjak ka kundërshtuar këtë propozim, sepse, siç thonë, vdekja e Aqif Blytës është një fakt i mirënjohur. Këshilli Kombëtar Boshnjak, në vitin 2012, ngriti pllakën përkujtimore për ta nderuar Aqif Blytën në një hapësirë ku mendohet se ishte shtëpia e tij, që sado pak t'i dalë hakut këtij vigani popullor. /Telegrafi/



Dështimet më të madha teknologjike të vitit 2021



Për shumë njerëz 2021-shi ishte një përzierje midis shpresave dhe sfidave, pasi vaksinat kundër Covid u bënë më të disponueshme, por pandemia zgjati edhe për një vit tjetër. Dhe ndërsa teknologjia vazhdoi të argëtohte dhe të na mbante të lidhur me njëri-tjetrin gjatë pandemisë, në disa raste ajo na e bëri jetën më të vështirë. Kjo pasi ka pasur disa raste kur teknologjia dështoi ose nuk funksionoi plotësisht, nga ndërprerjet e mëdha të internetit deri tek dëmshme kibernetike. Ja cila është lista e “CNN Business”, me disa nga dështimet teknologjike më të bujshme të vitit që po lëmë pas:

“Facebook” dhe “LinkedIn”, përjetuan rrjedhje masive të të dhënave konfidenciale

Në prill 2021 ekspertët e sigurisë kibernetike raportuan se informacioni personal i mbi gjysmë miliardë përdoruesve të “Facebook”, përfshirë numrat e telefonit, ditëlindjet dhe adresat e e-mailit, ishin postuar në një faqe interneti të përdorur nga hakerat. “Facebook” tha në atë kohë se të njëjtat të dhëna ishin raportuar më parë si të fshira nga profilet e njerëzve nga “aktorë dashakeq” në vitin 2019, dhe problemi u rregullua po atë vit. Por incidenti i ri tregoi edhe një herë se sa të

cënueshme mund të jenë nga “aktorët dashakeq” kompanitë që mbledhin sasi të shumta personale.

Po në muajin prill, “LinkedIn” konfirmoi se të dhënat e rreth 500 milionë profileve të përdoruesve të tij ishin ofruar për shitje në një faqe interneti të frekuentuar nga hakerat. Por në atë kohë kompania tha se baza e të dhënave të nxjerra në shitje ishte “në fakt një grumbullim i të dhënave nga një numër faqesh interneti dhe kompanish”, dhe se kjo “nuk përbënte një vjedhje të të dhënave të LinkedIn”.

Aplikacioni i kompanisë “Citizen”, identifikoi gabimisht një zjarrvënës të dyshuar

Në maj 2021 kompania “Citizen”, ku qytetarët mund të dërgojnë përmes një aplikacioni alarme për krimet që ndodhin në kohë reale, ofroi një shpërblim prej 30.000 dollarësh për të ndihmuar në zbulimin e autorit të një zjarri të madh në një zonë pyjore në Los Anxhelos.

Këshillat, përfshirë fotone një burri të postuar në aplikacion, e nxitën policinë të arrestonte një të dyshuar. Por kishte një problem shumë të madh: rezultoi se ai ishte identifikuar gabim. Kompania kishte përdorur një produkt të ri në aplikacionin e saj të quajtur “OnAir” për të transmetuar informacionin

rreth të dyshuarit, por tha se nuk kishte ndjekur protokollet e veta të verifikimit përpara se të qarkullonte informacionin.

Sulmet kibernetike u bënë një problem i madh

Këtë vit u shtuan ndjeshëm sulmet kibernetike që synojnë zhvatjen. Këtë herë ato shënjestruan veçanërisht bizneset dhe infrastrukturën kritike. Një sulm i madh në maj, nxori në pah cënueshmërinë e infrastrukturës amerikane ndaj krimeve të tilla.

Gazsjellësi Kolonial, një nga tubacionet më të mëdha në SHBA, u detyrua të ndërpriste punën kur rrjeti i tij u godit nga një sulm kibernetik, që me sa duket u bë i mundur nga disa hakera që kishin akses në një fjalëkalim të komprometuar.

Më vonë drejtuesi i gazsjellësit e pranoi se kishte paguar 4.4 milionë dollarë si shpërblim për të rikthyer në punën objektin. Në qershor, hetuesit amerikanë në Departamentin e Drejtësisë thanë se rikuperuan 2.3 milionë dollarë në kriptomonedha të paguara ndaj hakerave që qëndronin pas sulmit të Gazsjellësit Kolonial.

Dy ndërprerje (të shkurta) nxorën jashtë loje pjesën më të madhe të internetit

Ndodhën 2 herë në më pak se 2

javë. Pjesë të mëdha të internetit u shkatërruan për shkak të problemeve tek kompanitë e teknologjisë së informacionit, për të cilat shumica e njerëzve as që kanë dëgjuar kurrë. Ndërprerjet u zbuluan shpejt dhe ishin të shkurtra në kohë.

Por ato 2 episode treguan se sa të varur jemi nga interneti dhe sa i pasigurt mund të jetë ai. Në fillim, më 8 qershor, miliona faqe interneti, duke përfshirë Reddit, CNN, Amazon u ngadalësuan për shkak të një ndërprerjeje në rrjetin e shpërndarjes së përmbajtjes “Fastly”. Më pas, më 17 qershor, një problem tek një kompani të ngjashme, “Akamai Technologies”, goditi faqet e internetit, përfshirë edhe ato që i përkisnin “Southwest Airlines”, “United Airlines”, “Commonwealth Bank of Australia” dhe Bursës së Hong Kongut.

Por këto nuk ishin të vetmet dështime të mëdha të internetit këtë vit: Në dhjetor, shërbimi i “iCloud” i Amazon pësoi 3 ndërprerje që shkaktuan probleme serioze për “Disney+”, “Slack”, “Netflix” etj. Kjo avari ndërpreu operacionet logjistike të “Amazon” gjatë sezonit shumë të rëndësishëm të festave.

Një ditë e tmerrshme për “Facebook”

E hëna e 4 tetorit 2021 ishte e tmerrshme për kompaninë që së shpejti do të merrte emrin e


ri “Meta”. Një natë më parë, dekonspiruesja e sekreteve të “Facebook” Fesis Hogen zbuloi identitetin e saj në një intervistë për emisionin “60 Minutes”.

Hogen pretendoi se kompania e Zuckerberg e dinte se si rrjetet e saj sociale përdorëshin për të përhapur keq-informime, gjuhën e urrejtjes dhe dhunë. Më pas, të hënën, një defekt i rëndë mbylli për disa orë “Facebook”, “WhatsApp” dhe “Instagram”, për të cilën kompania fajësoi “ndryshimet në konfigurim”. Aksionet e saj ranë ndjeshëm.

Makinat “vetëdrejtuese” të Teslas i trembin shoferët

Kreu ekzekutiv i “Tesla”, Elon Musk, ka promovuar prej kohësh softuerin “vetë-drejtim i plotë” të kompanisë që prodhon makinat elektrike. Por ky lloj automjeti nuk është ende plotësisht autonom. Përkundrazi, shoferët duhet të rrinë vigjilentë në timon në rast se duhet të marrin përsipër drejtimin e mjetit.

Për më tepër, vetëm një numër i vogël drejtuesish të makinës “Tesla” kanë qenë në gjendje ta provojnë deri më sot, përfshirë një grup klientësh që kanë paguar nga 10.000 dollarë secili për të pasur qasje në versionin “beta” të këtij sistemi. / CNN – Bota.al



Prishtina mposhti Bashkimin në Prizren, Trepça shkatërroi Dritën

PRIZREN, 23 JANAR - Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Bashkimit në udhëtim me rezultat 62:81 (20:24, 17:17, 18:18, 7:21), në kuadër të javës së 17-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte mjaft i baraspeshuar, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej në epërsi, duke e bërë ndeshjen e barabartë, por me pesë pikë në fund, Prishtina e fitoi këtë pjesë 20:24. Edhe periudha e dytë ishte tërësisht e barabartë, që përfundoi 17:17, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 37:41, ku u veçua Alban Veseli me 16 pikë, duke qenë i saktë në tetë tentime. Edhe periuda e tretë

ishte tërësisht e barabartë në Prizren, pa arritur shkëputjen e madhe dhe përfundoi 18:18, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 55:59. Dallimi i madh dhe vendimtar u bë në dhjetë minutat e fundit. Në këtë pjesë shkëlqyen prishtinasit, duke qenë efikas në sulm dhe me mbrojtje të mirë, triumfuan me rezultat 62:81. Te Bashkimi u dalluan Alban Veseli me 19 pikë e dhjetë kërcime dhe Valon Bunjaku me 17 pikë, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Dachon Burke me 18 pikë e gjashtë kërcime dhe Jetmir Zeqiri me 19 pikë dhe shtatë kërcime. Bashkimi ka tetë fitore e nëntë



humbje, kurse Sigal Prishtina ka nëntë fitore dhe tetë humbje. Trepça ka shënuar fitore të thellë ndaj Dritës me rezultat 57:117 (17:22, 20:33, 9:26, 11:36), në takimin që u zhvillua në Mitrovicë, pa praninë e tifozëve, në kuadër të xhiros së 17-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Mitrovicasit ishin

në epërsi nga fillimi deri në fund për të shënuar fitore të merituar, që ishte e para në stinorin pranveror, ndërsa në tërësi kanë 11 fitore dhe gjashtë humbje, kurse gjilanasit kanë 17 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme në elitë pa fitore. Vetëm çereku i parë ishte më i barabartë, por që gjithsesi u kontrollua nga mitrovicasit dhe përfundoi 17:22. 'Xehetarët' filluan shkëputjen në periudhën e dytë, duke ngritur epërsinë, ndërsa shkuan në pushim me shifrat 37:55. Epërsia u thellua edhe më shumë në periodën e tretë, që u menaxhua mjaft mirë nga basketbollistët

mitrovicas, që nuk e kishin shumë të vështirë, ndërsa gjilanasit ishin të pafuqishëm për të bërë më shumë. Rezultati pas 30 minutash ishte 46:81. Dhjetë minutat e fundit ishin formalë me fituesin që tashmë ishte vendosur dhe Trepça triumfon me rezultat 57:117. Te Drita u dalluan Isaiah Jonnson me 13 pikë e 12 kërcime dhe Qëndrim Demi me 19 pikë, kurse te Trepça u dalluan Corbin Collins me 14 pikë, dhjetë kërcime e shtatë asistime, Drilon Hajrizi me 16 pikë e dhjetë asistime, Andrew Gordon me 13 pikë e 11 kërcime dhe Samir Zekiqi me 19 pikë.

Ademi takohet me Çeferinin, pret presidentin Ademi në shtëpinë e tij, presidenti i UEFA-s në pranverë vjen në Kosovë

PRISHTINË, 23 JANAR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi gjatë vizitës së sotme në Slloveni, pas takimit me kreun e Federatës së Futbollit të Sllovenisë, Radenko Mijatović, është pritur edhe nga presidenti i UEFA-s, Aleksander Čeferin, në shtëpinë e këtij të fundit në Grosuplje. Gjatë këtij takimi presidenti Ademi e njoftoi kreun e UEFA-s për gjendjen aktuale në FFK dhe projektet e mëtejme. Po ashtu, ia prezantoi programin e

planet e FFK-së nën udhëheqjen e tij dhe strategjinë e futbollit 2022-2026, si dhe paraqiti kërkesat për mbështetjen e projekteve dhe ideve të tij dhe KE të FFK-së. Presidenti Čeferin e përgëzoi presidentin e FFK-së për punën e bërë. Atij i pëlqyen idetë e paraqitura dhe u dha mbështetje të gjitha projekteve. Ai u interesua në detaje për punën e deritashme dhe vazhdimësinë e projekteve. Po ashtu, Čeferin e priti me kënaqësi dhe dëshirë të madhe



ftesën nga presidenti Ademi për ta vizituar Kosovën dhe për ta inauguruar punën e bërë deri më tash. "Numri një i futbollit evropian konfirmoi vizitën e tij në

Kosovë në pranverë, kur edhe do ta hapë zyrtarisht Kampin Edukativ Nacional në Hajvali, si dhe do të vizitojë Shtëpinë e Futbollit në Prishtinë, si dhe shumë fusha stërvitore, të cilat janë financuar nga programi "HatTrick" i UEFA-s. Ai gjithashtu do të inaugurojë fillimin e realizimit të projekteve në vazhdim. Presidenti Čeferin edhe një herë shprehu admirimin e tij për shtetin e Kosovës dhe për bashkëpunimin e mirëfilltë me

FFK-në", thuhet në njoftimin e FFK-së. Sipas këtij njoftimi, Čeferin e vlerësoi presidentin Ademi për punën e bërë dhe e inkurajoi të vazhdojë me ritëm dhe motiv të njëjtë. Ndërkaq, kreu i FFK-së e falënderoi presidentin e UEFA-s në emër të gjithë komunitetit të futbollit në Kosovë për udhëheqjen brilante të institucionit evropian të futbollit dhe për përkrahjen e vazhdueshme të FFK-së, por edhe federatave tjera.

Federata e Volejbollit siguron organizimin edhe të dy ngjarjeve rajonale



PRISHTINË, 23 JANAR - Drejtuesit e Federatës së Volejbollit të Kosovës në krye me presidentin Bahri Gjinovci, nënkryetaren Mimoza Shkodra dhe sekretarin e përgjithshëm Valon Nikqi, morën pjesën në asamblenë e 23-të ballkanike të volejbollit që mbajt në kryeqytetin e Maqedonisë

Veriore, Shkup. Në këtë mbledhje ndër të tjera u diskutua për organizatorët, datat dhe aktivitetet e vitit 2022, teksa Kosova arriti të sigurojë të drejtën për organizimin e ngjarjeve si, kampionati ballkanik U20 meshkujt, 'Beach Volley' U22 femrat dhe 'Beach Volley' U22

meshkujt. Datat kur do të zhvillohen këto ngjarje do të caktohet në ditët në vijim por që pritet të zënë vend gjatë korrikut ose gushtit të vitit 2022. Në mesin e përfaqësuesve të federatave ballkanike, në këtë asamble morën pjesë edhe presidenti i Konfederatës Evropiane të

Volejbollit (CEV) Aleksandar Boricic, zëvendës-presidenti Reanto Arena dhe drejtori për zhvillim Ozkan Mutlugil. Ndryshe javë më parë FVK, ka marrur konfirmimin për të qënë nikoqire e dy grupeve të kampionatit evropian për grupmosht U19 të femrat si dhe U22 për meshkuj.

Chelsea fiton derbin ndaj Tottenhamit

LONDËR, 23 JANAR - Chelsea ka arritur që ta fitojë derbin e qytetit kundër Tottenham, duke e mposhtur skuadrën e Antonio Contes me rezultat 2-0. Hakim Ziyech (48) dhe Thiago Silva (55) shënuan për Blutë e Londrës. Kane shënoi një gol në pjesën e parë por që u anulua pasi që më parë ishte shkaktuar faul në një lojtar të Chelsea. Qysh në fillim Chelsea rrezikoi. Calum Hudson-Odoi u shkëput mbi

mbrojtjen e Tottenham por nuk arriti ta godas si duhet topin i cili përfundoi afër shtyllës së majtë të Hugo Lloris. Pas këtij rasti ndeshja ishte me e qetë deri në minutën e 40-të kur Tottenham shënoi një gol. Por, gjyqtari i ndeshjes, Paul Tierney e anuloi atë pasi që më parë ishte shkaktuar faul në sulm tek mbrojtësit e Chelsea. Me të filluar pjesa e dytë, Chelsea do të vinte të

goli i parë. Hakim Ziyech u lirua për mrekulli, goditi topin me trinën e tij të brendshme aq saktë sa që ai përfundoi në trekëndëshin e portës së Hugo Lloris duke e zhbllokuar këtë sfidë me një gol të bukur në minutën e 48-të. Ziyech ishte afër të shënonte edhe një gol një minutë më vonë por Lloris kësaj radhe bëri një pritje brilante. Goli i dytë i Chelsea do të vinte nga një ndërprerje. Mason Mount

bëri një krosim perfekt në zonë për të gjetur aty mbrojtësin veteran, Thiago Silva i cili shënoi gol në minutën e 55-të të ndeshjes. Harry Kane e pati një mundësi të mirë për të shënuar një gol në minutën e 86-të të ndeshjes, por portieri i Chelsea ia mohoi atij golin. Kjo fitore e lënë në pozitë të tretë Chelsean por me 47 pikë, një më pak se Liverpool, por Blutë e Londrës kanë dy



ndeshje më shumë të zhvilluara se Chelsea. Tottenham mbetet në vendin e shtatë në Premier Ligë me 36 pikë, 2 më pak se Manchester United në vendin e katër që ka dy ndeshje më shumë të zhvilluara se "Gjelat" e Londrës Veriore.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	INDIVIDUAL CONSULTANT FOR ENVIRONMENTAL AND SOCIAL PERFORMANCE SERVICES
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2022/002
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Individual Consultant- Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo (MFK)
Publication Date	20 January 2022
Submission Deadline	10 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo (MFK), has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The MFK, the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for Environmental and Social Performance Services.

MFK is currently seeking a one (1) part-time or full-time ESP Individual Consultant to provide services towards effective implementation of the Threshold Program comprising of Reliable Energy Landscape Project and Transparent and Accountable Governance Project and several project related activities such as: Household Investments in Energy Efficiency (PIEE), District Heating Metering (DHM), Woman in Energy (WE), Independent Power Producer (IPP), Air Quality Information Management, and Dig Data Challenge on Air Quality (Dig Data). A flexible arrangement with a mix of in-person and remote work will be considered for the right candidate, however, the selected candidate will need to be available for frequent site visits in Kosovo.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/individual-consultant-for-environmental-and-social-performance-services-ic-mfk-2022-002>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **10 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address referred to above is:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	www.millenniumkosovo.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ramiz Bakalli Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Q.P.A. "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Mirabda Sahatiça Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, dhe diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Jeton Thaqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Ardi Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

► Dugagjin Rizanaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

► Ahmed Dani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Salmedin Kasi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Mjellma Nagavci nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Edukimit të lëshuar nga ish-SHLP "Bajram Curri" tash Universiteti "Fehmi Agani", Gjakovë.

► Lirim Dajaku shpalle te pavlefshme diplomën e ShMLT "Anton Ceta"

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

